



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 141/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në përbërje nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Besianë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Besianë, për shkak të vendosjes së banerëve mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

## VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Besianë, kështu që subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Besianë, i shqiptohet dënimi më gjatë në lartësi prej 1000 (Njëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

## Arsyetim

Me datën 04.06.2014 LVV dega në Besianë ka parashtruar ankesë në PZAP me të cilën pretendon se me datën 04.06.2014 aktivistët e LVV-së në Besianë diku rreth orës 11:55 kanë vërejtur se mbi rrugën "Zahir Pajaziti" në Besianë, ishte vendosur baneri i kandidatës Vjosa Sheholli me numër 87 nga koalicioni PDK-PD-LB-PSHDK përmbi rrugë publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe Rregullave Zgjedhore. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.06.2014, në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën deklaroi se posterat e kandidatit në fjalë janë hequr nga vendi ku kanë qenë të vendosura dhe se brenda afatit të paraparë është përmirësuar shkelja dhe si dëshmi ka

bashkangjitur fotografit nga vendi i ngjarjes duke i larguar banerët nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se banerat e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik PDK Vjosa Sheholli janë të vendosura mbi rrugët publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik PDK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se banerat e kandidatit të saj për deputet kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e tyre. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës së PZAP-it për përgjigje në ankesë, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë banerat nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik PDK është shkelur neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që banerat e kandidatit të saj janë vendosur mbi publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të

bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 141/2014 më datën 06.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Xhevdet Abazi**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*